



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJILANIT  
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

**Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale**

Adresa: Rr .Isa Boletini pn. tel.; +381 (0)280 23 603 ,e-mail :  
dshcs@gjilani-komuna.org



***DREJTORIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES  
SOCIALE GJILAN***

***RAPORTI VJETOR I PUNËS  
2012***

DR XHEMAJL SALIHU  
DREJTOR

## **RAPORT PUNE I SEKTORIT SHËNDETËSOR -Janar-Nëntor 2012**

- DSHMS-ja në prioritetet e saja ka qëllim kryesor monitorimin e përgjithshëm të ofrimit të shërbimeve shëndetësore , përkujdesjen maksimale të Kujdesit parësor Shëndetësor të popullatës në nivel Lokal.
- DSHMS-ja bënë monitorimin e punës në : QKMF, QPS etj.
- Në Kuadër të DSHMS- Funksionon Sektori Shëndetësor
- Sektori Shëndetësor dhe zyrat e punës në kuadër të sajë bëjnë Monitorimin e vazhduar të punës në QKMF dhe rrjetin e saj Ambulator

-Sektori Shëndetësor Funksionon me (3) zyra Pune

Shefi i Sektorit Shëndetësor

**1. Zyra për Shëndet Publik**

**2. Zyra për Shërbime Shëndetësore**

**3. Zyra për Ujë**

### **Aktivitete Bashkëpunimi- Realizimi**

- Bashkëpunim periodik me OJQ ,CDI,caritasin,unicef etj
- **Bashkëpunim ,Qendra Liria-Gjilan** takime 4 raste Pjesëmarrje
- **Pjesëmarrje projektin** nga UNFPA Dhuna në familje
- **Monitorimi i zbatimit planit të punës** në QKMF,AMF për 2012 etj.
- **Vizite pune në QKMF** dhe Qendrat tjera të Mjekësisë Familjare Gjilan etj
- **Bashkëpunim me KFORIN TURK** me rastin e ceremonisë të synetisë .
- **Bashkëpunim me Drejtorinë e Arsimit** për realizimin e projektit, EDUKIMI DHE TRAJNIMI për klorizimin e ujit në puse për furnizim me të sigurt me ujë të pijshëm pishëm në institucionet Shkollore dhe Ambulanta

**Takim pune me përfaqësuesit e barnatoreve**

Në kuadër të zhvillimit të punës për periudhën Janar-Nëntor 2012, janë zhvilluar aktivitete si në lëmin e edukimit shëndetësor të popullatës poashtu edhe në sferën e propagimit edukativ-shëndetësor

- Gjatë muajit Janar- Shkurt është bërë monitorimi i sëmundjeve ngjyese në banorët e fshatrave Cernice, Zheger, Nasale, Lladove, Shurdhan, Livoq i Poshtëm, Pogragje, Bresalce njëkohësisht me Mostruesin nga IRSHP-ja përveq marrjes së mostrave të ujit janë bërë disa hulumtime të puseve rreth zonës mbrojtëse të tyre duke vënë në pah sigurinë e zonës mbrojtëse të puseve në institucionet publike shkolle dhe Ambulanta
- Në bashkëpunim me Ojq-CDI janë vizituar fshatrat Bresalce, Pogragje rreth projektit të rregullimit të ujësjetës dhe kanalizimit në këto lokacione në bashkëpunim me Drejtorinë e Arsimit dhe përfaqësuesin e bashkësisë fetare kemi bërë inspektimin e shkollave të institucioneve fetare: Gjimnazi i përgjithshëm ( medrese ) “Al-laudin”, Konvikti për nxënës skamënor dhe kurse Kuranore “Sylejmani”, Konvikti për nxënës “Ali Jakup Efendi”, Bashkësia “Ringjallja”,

Bashkësia "Ungjillore"- Qiriazhi , OJQ "Njeshmeria"rr."Fadil Jakupi",Kopshti"Mesonjetorja Qiriazhi

- Implementim I projektit per dezinfektim dhe për DEZINFEKTIM HAPSINOR dhe hapsirava te mbyllura siq jane objektet shkollore parashkollore institucione shendetesore etj, Dezinfektimi dhe dezinfektimi perafersisht i hapsires se komunes dhe rrethines ne siperfaqe prej 1000 hektarësh cila eshte zhvilluar ne katër ETAPA kohore
- Nga Zyra për Shëndet Publik jane udhëzuar ,per Ministrin e Shëndetësisë ne baze te rekomandimit te mjekeve konziliar te QKU-se  
**70 raste per trajtim jashte vendit**  
24 raste, semundje kardiovaskulare  
3 raste, Me semundje te traktit digjestiv  
11 raste me semundje oftalmologjike,  
14 raste me semundje ortopedike  
9 raste raste semundje tumorale  
3 rasteme sëmundje neurologjike  
6 raste me sëmundje te gjakut .

### **ZYRA PËR SHËRBIME SHËNDETËSOR**

Nga Zyra për shërbime shëndetësore për gjatë periudhës Janar- Nëntor të vitit 2012 janë kryer punë si dhe obligime zyrtare me të cilat ngarkohet kjo zyrë .  
Përshkrimi i punëve gjatë muajve Janar –Nëntor disa nga punët kryesore.

- Ne ZSHSH –Drejtohen shumë kërkesa te palëve per ndihm ne nevojat e tyre te ndryshme shendetësore
- Nga muaji Janar –Nëntor Kjo zyre ka pranuar gjithsejt **291** Kërkesa kryesisht per ndihem shendetesore
- Për **157** kërkesa komisioni vlerësues ka aprovuar ndihma të niveleve të ndryshme (30-300E).
- Mjete te shpenzuara te pergjithsme jane ne vlerë **12 120 euro.** Per kërkesa te palëve
- 134 Kërkesa jane proceduar nga komisioni perkates vlersues si te pamjaftueshme ne dokumentacionin e aplikimit dhe qe jane vlersuar si kërkesa te refuzuara

| VITI | Nr kerkesave | Te aprovuara | Te refuzuara | Mjetet e dhena |
|------|--------------|--------------|--------------|----------------|
| 2012 | 291          | 157          | 134          | 12120          |
| 2011 | 531          | 240          | 281          | 18220          |

- **Zyra për ujë** bën hulumtimin dhe monitorimin permanent të cilësisë së ujit të pijshëm ne gjithë zonën e banuar të Komunës së Gjilanit

- Marrje mostra Uji per hulumtim te rregullt te ujit te Pijshem ne objektet institucionale-shkollore dhe ambulanta ne zonat.Rurale dhe raste te tjera siq janë objekte private ne mungesë të ndonje objekti institucional publik

#### **hulumtimi i kualitetit te ujit i bere ne kater gjiro**

- **Ne 10** Lokacione ne objekte shkollore dhe ambulanta janë marrë 20 mostra per hulumtim kimik dhe bakteriologjik 10 mostra kimike dhe 10 bakteriologjike te cilat jane analizur zyrtarisht dhe jan vlersuar me nje raport pune per situaten e furnizimit dhe cilesise me uje te pijshem nga keto objekte uji në institucionet publike te zonës Rurale
- **Gjate tre mujorit te dyte Janë hulumtuar 5 mostra uji ne Lagjen e Muhagjerëve** te Uglarit kerkese e qytetarëve(puse Private) te deponia e mbeturinave
- **Pase Xhiros së –III-të Zyra për ujë pas vlersimit dhe analizes se pergjithsme te suate me furnizim me uje të pijshën ne keto objekte uji ne lokacionet respektivisht institucionet shkollore dhe ambulanta nxjerr përfundimi per veprimin praktik te zbatimit te projektit per klorizim te ujit ne keto objekte publike**
- **EDUKIMI DHE TRAJNIMI** për klorizimin e ujit ne puse . Në Objektet e Institucioneve **ARSIMORE dhe SHENDETËSORE-Ambulanta** në zonat rurale.Takim pune është realizuar ne Sallen e Drejtorisë së Arsimit me pjesëmarrje të Puntorëve teknik-Shtëpiakve nëpër shkollat perkatese siq janë **Shkolla fillore ne, Pogragjë, Mireshe, Malishevë Kmetovcë ,Uglar. Zhegër, Lladovë ,Llashticë Mihir Poneshe,Bukovik et**
- Pas Trajnimit dhe edukimit janë bërë edhe përgaditjet teknike për shpërndarjen e klorit ne lokacionet perkate

Qendra kryesore e mjekesis familjare

#### ***Kujdesi parësor shëndetësorë siguron:***

- Parandalimin, zbulimin, diagnosifikimin, mjekimin dhe rehabilitimin , përfshirë edhe ndërhyrje të vogla kirurgjike.
- Mbrojten specifike të fëmijëve dhe të rinjëve,
- Ruajtjen dhe përparimin e shëndetit publik,
- Promovimin e shëndetit oral,
- Furnizimin me barna dhe kujdesin farmaceutik,
- Rehabilitimin fizikal dhe psikosocial,
- Sigurimin e përkujdesjes së ujit të pijshëm dhe artikujve ushqimorë,
- Ruajtja e shëndetit hapsinorë,

- Zbatimin e ligjeve kundër përdorimit të duhanit dhe ndotëseve të tjerë të ajrit,
- Organizimi i shërbimeve të urgjencës mjekësore,
- Shërbimi i kujdesit antenatal dhe planifikimin familjarë,
- Kujdesin pailitaiv,
- Kujdesin ndaj sëmundjeve kronike .

## II. Stafi Punonjës :

| Mjek | Infermier | Administrate | Punetor tjere | Totali |
|------|-----------|--------------|---------------|--------|
| 75   | 154       | 8            | 47            | 284    |

Në këtë numër të punëtorëve hyjnë edhe punëtorët e komunitetit Serb , Turq, Rom e të tjerë.

Sipas nacionalitetit kemi këtë përbërje të punetoreve :

| Shqiptare | Serb | Turq | Rom | Të tjerë | Totali |
|-----------|------|------|-----|----------|--------|
| 262       | 10   | 10   | 1   | 1        | 284    |

Në kuadër të QKMF-së funksionojnë: 1 QKMF, 12 Qendra të mjekësisë familjare (QMF) , 10 Ambulanca të Mjekisë Familjare (AMF), 3 AMF mobile.

## IV. Raporti i shërbimeve shëndetësor.

| <i>Puna sipas shërbimeve</i>  | <i>Vizita</i> | <i>Referime</i> | <i>Intervenime</i> | <i>Infuzionet</i> | <i>Lidhjetë plagëve</i> | <i>Inhalime</i> | <i>Viz.shtepiake</i> |
|-------------------------------|---------------|-----------------|--------------------|-------------------|-------------------------|-----------------|----------------------|
| <i>Mjekësia familjare</i>     | <i>156773</i> | <i>29179</i>    | <i>67850</i>       | <i>5346</i>       | <i>5346</i>             | <i>3362</i>     | <i>0</i>             |
| <i>Kujdestaria e femijëve</i> | <i>7491</i>   | <i>540</i>      | <i>3063</i>        | <i>54</i>         | <i>134</i>              | <i>495</i>      | <i>0</i>             |
| <i>Ndihma e shpejetë</i>      | <i>32109</i>  | <i>3830</i>     | <i>32154</i>       | <i>1392</i>       | <i>726</i>              | <i>680</i>      | <i>1579</i>          |
| <i>Stomatologjia</i>          | <i>27611</i>  | <i>0</i>        | <i>0</i>           | <i>0</i>          | <i>0</i>                | <i>0</i>        | <i>0</i>             |
| <i>Laboratori</i>             | <i>19149</i>  | <i>0</i>        | <i>0</i>           | <i>0</i>          | <i>0</i>                | <i>0</i>        | <i>0</i>             |

|                          |               |              |               |             |             |             |             |
|--------------------------|---------------|--------------|---------------|-------------|-------------|-------------|-------------|
| <i>Qendra e diabetit</i> | 2328          | 60           | 88            | 86          | 0           | 0           | 0           |
| <i>Kujdesi paliativ</i>  | 0             | 0            | 127           | 110         | 10          | 0           | 0           |
| <b>Totali</b>            | <b>245461</b> | <b>33609</b> | <b>103282</b> | <b>6988</b> | <b>6216</b> | <b>4537</b> | <b>1579</b> |

## V.SHERBIMI I VAKSINIMIT

RAPORTI PER AKTIVITETET E KRYERA PER PERIUDHEN  
11 MUJORE : JANAR - NENTOR 2012

Sherbimi i vaksinimit i cili funksionon ne kuader te QKMF se ka kryer aktivitetet e parapara me planin vjetor per vitin 2012 te cilat kane te bejne me vaksinim e femijeve parashkollore dhe atyre shkollore . Keto aktivitete jane zhvilluar ne tere teritorin e komunes se Gjilanit si ne qytet poashtu eshe ne fshatra si ato me objekte shendetesore poashtu edhe fshatrat pa objekte shendetesore ku vaksinimi ketu kryhet nga ekipet mobile te sherbimit te vaksinimit te cilat mbulojne edhe pjeset me te largeta te komunes .

Poashtu eshte bere edhe vaksinimi i te rriturve dhe femijeve me vaksine kunder gripit sezonal ku kemi vaksinuar 5600 persona te rritur duke perfshire personat e semure nga semundjet kronike , pensionistet , pacientete dializes, poashtu kemi vaksinuar pacientet ne probleme nga shoqata e te verberve , hendikosi . Kete vit jemi duke bere edhe vaksinimin e femijeve me probleme shendetesore me vaksine k  
Kunder gripit sezonal .( 200 doza )

### VI. Qendra e trajnimit

Në kuadër të QKMF-së vepron Qendra e trajnimit të Mjekësisë Familjare e cila funksionon si njësi e Qendrës për Zhvillimin e Mjekësisë Familjare dhe Qendra e Edukimit të Vazhdueshëm profesional për infermiere e cila gjat këtij viti ka realizuar një sërë projektesh si në ngritjen e profesionale të punëtorëve shëndetësorë me tema të ndryshme, poashtu edhe në komunitet janë realizuar një sërë aktivitetesh në lidhje me edukimin e klientëve .

### ***Qendra e Trajnimit dhe Edukimit të Vazhdueshm profesioanl ka realizuar :***

- 14 Ligjerata për mjek me pjesëmarje 242 mjek dhe 82 infermier.
- 42 Ligjerta per infermier me pjesmarje 584 infermier të ndarë në grupe
- 6 Ligjerata në komunitet ku jane të përfshirë femijet e qerdheve, edukatorët dhe arsimtarët .

### ***Aktivitet tjera***

- Promovimi i revistës “Shëndeti”,
- Manifestimi për nder të 12 Majit Ditës së Infermierisë,

- Mbajtje të trajnimeve dhe ligjeratave nga ana e mjekëve,
- Mbajtja e ligjëratave nga ana e infermiereve ne komunitet dhe institucion,
- Aktivitet për nder të Ditës Ndërkombëtare Kundër Duhanit,
- Dita ndërkombëtare kundër drogës, me moten “I shëndosh stop drogës “,
- Java e shëndetit oral aktivitete në shkollat 6 shkollat e Gjilanit,
- Aktivitete për ditën ndërkombëtare e diabetit,
- Trajnimi i mjekeve dhe infermiereve për menagjimin e stresit,
- Ligjerta në qerdhet e femijëve dhe edukimimi për variqiell dhe skabies,
- Trajnimi i stafit të emergjencës,
- Trajnimi për ushqishmërinë e foshnjës,
- Edukimi i nxënësve dhe grave në fshatin Kishna Pole,
- Vaksinimi i qytetarëve me vaksinen kundr gripit sezonal,
- Syntija e fëmijëve nga KFOR-i Turk,
- Vlersimi i gjendjes shendetesore te nxenesve te klases se pare, peste dhe te nente ne te gjitha shkollat e komunes se Gjilanit.

Gjatë muajit Janar janë mbajt ligjërata ne 3 qerdhe te fëmijëve nga pediatri dr. Hajriz Ibrahim, ne çdo te enjte vizitohen mesatarisht 7deri 10 fëmije në 3 qerdhe te qytetit te Gjilanit.



### **Donacionet**

Donacion nga kompania “Alkaloid” dhe “Apipharm”

Inventare donacion nga Eulex

88 Mantila donacion për të gjith mjekët nga kompania farmaceutike “KRKA”

Donacion nga Caritas-i numerues hematologjik për AMF Kishnapole

Donacion nga Caritas-i me paisje mjekësore për të gjitha QMF-të dhe AMF-të

Donacion nga “PLIVA” (veshja e karrikave stomatologjike)

Donacion e tre kompjutereve nga “TREPHEARM”

### **Investimet në infrasatrukturë.**

Renovimi total në QMF Bresalc.

Renovimi në AMF Kishna Pole në proces .



QMF BRESALC



AMF KISHNAPOLE

### MIREQENI SOCIALE

Zyra për Mirëqenje Sociale në periudhën: **01.01- 07.12.2012** në kuadër të Drejtoratit për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale ka punuar në zbutjen e gjendjes së rëndë sociale me të cilën po ballafaqohet pjese e madhe e qytetareve

### *Ndihmat në sferën sociale*

Ka punuar në zbulimin dhe evidentimin e rasteve sociale në teren dhe në këtë aspekt ka bashkëpunuar me Qendrën për punë Sociale në zbutjen e kësaj gjendje.

Kemi koordinuar grupin për monitorimin e punëve të fëmijëve, ku kemi mbajtur gjatë këtij viti dy puntori dhe disa takime pune.

Gjatë kësaj periudhe kemi shqyrtuar 150 kërkesa për pako ushqimore ku 90 kërkesa janë rekomanduar për miratim ndërsa 60 kërkesa janë refuzuar po ashtu janë shqyrtuar edhe 70 kërkesa për pagesë të qiras dhe zgjedhjes së çështjes së banimit ku ne munges të mjeteve për vitin 2012 komisioni nuk ka mundur të rekomandojë për miratim nga këto kërkesa 6 kërkesa janë rekomanduar zyres për projekte dhe 4 të tjera presi përgjegjëje. Kemi përfunduar projektin e dimërimit ku janë ndihmuar me pako ushqimore 300 familje kryesisht në fshatra dhe me dru për ngrohje janë ndihmuar 345 familje në qytet nga këto familje 43 janë serbe dhe 90 familje romë

Kemi bërë shpërndarjen e druve të prera në qytet ku kanë përfituar 24 familje me nga 2 m dru

Duke e parë një krizë të madhe në qytet dhe në fshatra nga një motë e vështirë ne si drejtori kemi hartuar një projekt emergjent ku nga ky projekt janë ndihmuar 200 familje me nga një pako dhe 110 familje me dru për ngrohje

Kemi pasur edhe dy donacione që kanë ofruar miell për familjet skamnore.

1300 kg miell i ka ofruar NTP DIAMANT ku nga 50 kg kanë përfituar 26 familje dhe

1000 kg i ka ofruar KOMPAKT GRUP ku mielli është ndar një familje 50 kg dhe nga 25 kg kanë përfituar 38 familje kryesisht familje që jetojnë në banesat sociale.

Kemi kryer obligimet për muajt Gusht 2011 deri Gusht 2012 për familjet e Dhëshmorve dhe invalidve sipas rregullores komunale me nr.01-3378/09 datë 30.03.2009 që janë 20 familje x 130€ x 13 muaj që kapin shumen 33.800 €

Po ashtu kemi kryer edhe obligimet për muajin Maj 2011 deri tetor 2012 për familjet e puntorve që kanë qenë shërbysë civil të cilët janë të vdekur ku ndihmohen sipas rregullores komunale me nr.01-8033/02 datë 08.10.2002 që këtë të drejtë e shfrytzojnë 5 familje x 100 € x 18 muaj që kapin shumen 9.000 €

Kemi kryer edhe obligimet e qirasë për Maj- Qershor 24 familje x 50 € x 2 muaj që kap shumen prej 2400 €

Pas marveshjes në mes të Komunes dhe familjes Zylfiu ku në objektin për banim janë vendosur 9 familje ne kemi kryer pjesën e fundit të obligimeve për vitin 2011 ku kemi paguar shumen e mbetur prej 2750 € si dhe fazën e parë të vitit 2012 që kapë shumen 7.250 €

### **Sektori i Shërbimeve Sociale-Profesionale**

Në vazhdim po ju prezantojmë rastet sociale të cilëve, gjatë periodës 01.01/12 - 30.11/12, ju janë ofrua shërbime sociale:

|                                                                                                                                                 |     |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----|
| 1. rastet e fëmijëve të braktisur nga prindërit dhe të strehuar në familjet strehuese,.. 7 fëmijë, 6 prej tyre të bartur nga vitet e mëhershme, |     |
| 2. Caktimi i kujdestaris për fëmijë pa kujdes prindorë, .....                                                                                   | 39  |
| raste,                                                                                                                                          |     |
| 3. Rastet të tentim pajtimit të bashkëshortëve.....                                                                                             | 33  |
| raste,                                                                                                                                          |     |
| 4. Dhënja e mendimit për besimin e fëmijëve.....                                                                                                | 26  |
| raste,                                                                                                                                          |     |
| 5. Ndihm në realizimin e kontakteve prind-fëmijë.....                                                                                           | 19  |
| raste,                                                                                                                                          |     |
| 6. Rastet e të miturve në konflikt me Ligjin .....                                                                                              | 76  |
| rate,                                                                                                                                           |     |
| 7. Rastet e fëmijëve me sjellje asociale .....                                                                                                  | 30  |
| raste,                                                                                                                                          |     |
| 8. Rastet e dhunës në familje .....                                                                                                             | 28  |
| raste,                                                                                                                                          |     |
| 9.Rastet e të moshuarve në nevoj për shërbime .....                                                                                             | 2   |
| raste,                                                                                                                                          |     |
| 10. Fëmijë të strehuar tek të afërmit.....                                                                                                      | 26  |
| fëmijë,                                                                                                                                         |     |
| 11. Prezantim në Seanca Gjyqësore-Prokurori .....                                                                                               | 11  |
| raste                                                                                                                                           |     |
| 12. Prezantim në Polici për raste të ndryshme.....                                                                                              | 103 |
| raste,                                                                                                                                          |     |

|                                                            |      |
|------------------------------------------------------------|------|
| 13. Vizita të ndryshme në familje dhe institucione.....    | 419, |
| 14. Konsultime me palë për nevoja të ndryshme sociale..... | 554  |

raste etj.

Kur kemi të bë me fëmijët pa përkujdesje prindore, ndër format më të preferuara të mbrojtjes Sociale të cilat I aplikon Shërbimi I QPS-ës janë:

- strehimi familjar, ku për momentin kemi gjithsejtë shtatë(7) fëmijë të braktisur nga prindërit, e që janë të sistemuar në familjet strehuese. Pagesën, në shumë prej 150€ në muaj për nj fëmijë e bart MPMS.
- Fëmijët në strehim familjarë tek të afërmit. Këtë formë të strehimit, me pagesë mujore pre 75€, tani jemi duke e aplikuar për gjithsejtë 26 fëmijë.
- Fëmijët nën kujdestari, si formë e mbrojtjes së fëmijëve pa përkujdesje prindore është duke u aplikuar tek 39 fëmijë.

Fëmijët me nevoja të veçanta,

Duke pasur parasysh rolin dhe vështirësitë me të cilat ballafaqohen familjet në mbrojtjen dhe kujdesin e fëmijëve me nevoja të veçanta, MPMS, ka marr vendim për miratimin e Ligjit Nr.03/L-022/08 me të cilin rregullohet e drejta për përkrahje materiale familjet të cilat kanë fëmijë me nevoja të veçanta të përhershme. Sipas këtij Ligji familjet e gëzojnë këtë të drejt, në shumë mujore prej 100€ për nj fëmijë dhe atë duke filluar nga mosha një(1) vjeçare e fëmiut, deri në moshën tetëmbëdhjetë(18) vjeçare.

Tani këtë formë të mbrojtjes materiale, në Komunën e Gjilanit, e gëzojnë 182 fëmijë.

## Sektori i Asistencës Sociale

Puna dhe aktivitetet në skemën e Asistencës Sociale, gjatë periudhës 01.01.2012-30.11.2012, janë zhvillua në përputhje me Ligjin për Skemën e ndihmave Sociale të Kosovës Nr.2003/15, Rregullores Zbatuese Nr.2003/20, planit të punës, si dhe nevojave të paraqitura në momente të caktuara.

Për gjatë kësaj periode njëmbdhjetmujore( 01/12-11/12), QPS-ja ka ofrua Asistencë Sociale mujore, mesatarisht, 1167 familjeve me gjendje të rënd sociale, prej tyre rreth 50 familje minoritare. Shumë mesatare mujore e paguar për nj familje është 65€.

Duhet të ceket se MPMS, për gjatë kësaj periode njëmbdhjetmujore, ka bërë pagesën e familjeve në AS të Komunës së Gjilanit në shumë totale prej 832.065€, apo mesatarisht 75.642€ në muajë.

Aktivitetet e Sektorit të Asistencës Sociale që vlejné të veçohen:

- Pranimi, shqyrtimi dhe përpunimi i kërkesave të aplikantëve për ndihmë Sociale, gjithsejtë 507 kërkesa të reja, prej tyre janë aprovuar 328 kërkesa, derisa janë refuzuar 179.

- Përcjellja e ndryshimeve eventuale, përmes verifikimit permanent të familjeve shfrytëzues të ndihmave Sociale. Për gjatë kësaj periode janë krye, në forma të ndryshme, 3328 verifikime.
- Pranimi dhe prezantimi i lëndëve Komisionit Mjekësorë, gjithsejtë 1403 lëndë.
- Pranimi i ankesave, shqyrtimi i tyre dhe përcjellja në nivelin qendrorë, komisioneve pran DMS,
- Bashkëpunimi me Qendrën rajonale të punësimit,
- Gjatë kësaj periode Sektori i Asistencës Sociale, ka lëshua gjithsejtë 429 Vërtetimeve për qytetarë si shfrytëzues-mos shfrytëzues të ndihmave Sociale.